



DT/DSHT Nr. 5943 prot.

Tiranë, më 29.09.2022

## **Kritere të tjera për regjistrimin e PPB-ve dhe integrimin në Platformën e Menaxhimit të Tregut të OST**

Duke filluar nga data 29.09.2022, OST sh.a në përputhje me parashikimet e pikës 4.2.2.2 dhe 5.2.3.5 të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit, njofton që cdo pjesëmarrës tregu që kërkon të regjistrohet në Tregun Shqiptar të Balancimit, krahas kritereve të publikuara nga OST sh.a, të plotësojë gjithashtu edhe këto kritere dhe të paraqesë dokumentacionin që verteton përmbushjen e tyre:

### Kriteri

- Identifikimi i pikës së lidhjes në sistemin elektroenergjitik shqiptar, kapaciteti i pikës së lidhjes<sup>1</sup>

### Dokumentacioni

- Marrëveshja e lidhjes me rrjetin
- Vërtetim nga Operatori i Sistemit përkatës në të cilin është lidhur, për vlefshmërinë e marrëveshjes së lidhjes

### Kriteri:

- Identifikimi i pikës së matjes<sup>2</sup>

### Dokumentacion:

- Dokumentacioni teknik i matjes sipas intervaleve të caktuara kohore që perputhet me kërkesat e Kodit të Matjes.
- Protokollin e matjes i mbajtur në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe rregullatore në fuqi.
- Aktin e lëshuar nga Operatori i Sistemit përkatës për kalimin e fazës së testimit të sistemit të matjes mbi integrimin në Platformën e Menaxhimit të Matjeve

<sup>1</sup> E aplikueshme për përdoruesit që e kanë këtë detyrim ligjor

<sup>2</sup> E aplikueshme për përdoruesit që e kanë këtë detyrim ligjor

Kriteri dhe dokumentacioni:

- Marrëveshja e operimit me rrjetin e transmetimit<sup>3</sup>

Regjistrimi i cdo pjesmarrësi tregu si PPB dhe integrimin ne Platformen e menaxhimit të tregut të OST sh.a, do të kryhet vetëm pasi janë përmbushur kriteret e mësipërme.

**ADMINISTRATORI I OST SH.A**



**Skërdi Drenova**

OST  
SISTEMI  
TRANSMETIMIT

---

<sup>3</sup> E aplikueshme për përdoruesit që e kanë këtë detyrim ligjor